



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 17.02.2016

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “KORPUSI AVOKATIA”, ME
VENDNDODHJE NË RRUGËN “ANA KOMNENA”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullosës së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Korpusi Avokatia”, me vendndodhje në Rrugën “Ana Komnena”, Bashkia Tiranë me subjekt kërkues Dhomën Kombëtare të Avokatisë së Shqipërisë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT